

THIRRJE PËR APLIKIM PËR RECENSESUES PËR VLERËSIMIN E TEKSTIT SHKOLLOR TË VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

1. Komisioni i përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, shpall thirrjen për aplikim për recensues që do të vlerësojnë tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”. Ftohen të aplikojnë individë që përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Paketën e dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të tekstit të vetëm të përbashkët “Abetare” ([klikoni këtu për paketën](#)), miratuar në janar 2022 nga ministri i Arsimit dhe Sportit i Republikës së Shqipërisë dhe ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit i Republikës së Kosovës.
2. Vlerësimi i tekstit shkollor në dorëshkrim bëhet nga recensentë, nga të dyja vendet. Recensentët duhet të jenë specialistë/pedagogë të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, mësues të arsimit fillor dhe redaktorë gjuhësorë.

- Dokumentet të ngarkohen në formatin pdf në linkun përkatës sipas aplikimit më poshtë:

2.1. Specialist/pedagog i gjuhës shqipe që plotëson kriteret:

- Të ketë gradë shkencore ose titull akademik, në fushën e gjuhës shqipe.
- Të ketë kontribute në fushën përkatëse (botime, konferenca).
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

[Klikoni këtu](#) për të aplikuar si specialist/pedagog i gjuhës shqipe

2.2. Specialist/pedagog i letërsisë që plotëson kriteret:

- Të ketë gradë shkencore ose titull akademik, në fushën e letërsisë.
- Të ketë kontribute në fushën përkatëse (botime, konferenca).
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

[Klikoni këtu](#) për të aplikuar si specialist/pedagog i letërsisë

2.3. Mësues i arsimit fillor që plotëson kriteret:

- Të jetë i diplomuar si mësues/mësimdhënës për arsimin fillor/klasor.
- Të jetë mësues në arsimin fillor në Shqipëri ose në Kosovë.
- Të ketë përvojë pune mbi 10 vjet si mësues i arsimit fillor/klasor.
- Të ketë kualifikime dhe trajnime në fushën e mësimdhënies.
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

[Klikoni këtu](#) për të aplikuar si mësues i arsimit fillor

2.4. Redaktor gjuhësor që plotëson kriteret:

- Të jetë diplomuar, me ciklin e dytë të studimeve në fushën e gjuhës shqipe.
- Të ketë përvojë në redaktimin gjuhësor në fushën e botimeve.
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve shkollore.

[Klikoni këtu](#) për të aplikuar si redaktor gjuhësor

Aplikimet do të pranohen nga data 14 shkurt – 28 shkurt 2022.